REPUBLIKA E SHQIPERISE

Ministria e Ekonomise Publike
dhe Privatizimit

Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Mesme e te Vogla

**URDHER**
**Nr 319 Date 7.9.1999**

**PER**
**PRIVATIZIMIN ME ANKAND PA CMIM FILLESTAR TE PAKETES SE AKSIONEVE SHTETERORE TE SHOQERISE ANONIME "INDUSTRIALIMPEKSI " TIARNE**

Ne baze nenit 2 te Ligjit Nr.8237 date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926 date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" ndryshuar me akte te tjera ligjore, me cilesine e aksionerit te vetem , ne mbeshtetje te Ligjit Nr 8334 date 23.4.1998 " Per privatizimin e shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjik , V.K.M. Nr. 446 date 9.7.1998 "Per procedurat e privatizimit me ankand te paketave shteterore te aksioneve te shoqerive tregatre qe veprojne ne sektoret jo strategjik, VKM Nr. 684 date 28.18.1998 "Per nje shtese dhe ndryshim ne VKM Nr. 446 date 9.7.1998 "Per procedurat e privatizimit me ankand te paketave shteterore te aksioneve te shoqerive tregtare, qe veprojne ne sektoret jo strategjike, VKM Nr 405 date 31.8.1999 "Per procedurat e privatizimit me ankand pa cmim fillestar te paketave shteterore te aksioneve te disa shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jostrategjik, VKM Nr 407 date 31.8.1999 "Per privatizimin me ankand pa cmim fillestar te paketave shteterore te aksioneve te disa shoqerive tregtare"

***Urdheroj:***

1-Te privatizohet me ankand, pa cmim fillestar paketa shteterore e aksioneve te "Industrialimpeksi" Sh.A Tirane , sipas V.K.M. nr 405 date 31.8.1999 , dhe V.K.M.nr 407 date 31.8.1999.

Tirane - Sheshi "Skenderbej" 2, [illegible]

-Transferimi i paketes shteterore te aksioneve ne masen 51 %. percaktuar sipas V.K.M. Nr 684 date 28.10.1998 .

3-Dokumentacioni i depozituar ne Agjensine Kombetare te Privatizimit me shkresat nr 4454 date 08 07.1999 sipas V.K.M nr 446 date 9.7.1998 te sherbeje per fillimin e procedurave te privatizimit.

4-Transferimi i aksioneve ne perputhje me piken 2 te ketij urdheri te perfundoje brenda afateve ligjore ne fuqi

5- Urdheri nr 43 date 08. 07..1999 anullohet.

**MINISTRI**

**Ylli BUFI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE
Nr 3008 Rep 21.12.1998
VERTETIM
Z U. Qu... me Nr Pasaporte
Paraqiti Dokumentin Origj Unë Vërtetoj
që Fotokopja Është një me Origjinalin

AFERDITA HAXHIA
TIRANE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTER ...........
Nr. ....Regj.Nr. ..320..Kol.

Tirane, 17.11. 1999

# KONTRATE

## PER SHITJEN (TRANSFERIMIN) E PAKETES SHTETERORE PREJ 51% (PESEDHJETE E NJE PERQIND) TE "INDUSTRIALIMPEKS"SH.A. TIRANE

Sot, me date17.11.1999 (njemije e nenteqind e nentedhjete e nente), diten e merkure , ne Agjensine Kombetare te Privatizimit Tirane, perpara meje noteres se Dhomes se Noterise Tirane, Z. ........... hartohet kontrata e shitjes se paketes se aksioneve prej 51% e barabarte me 21930 aksione ne "Industrialimpeks" Sh.A.Tirane te regjistruar ne Gjykaten e Rrethit Tirane me Vendimin Nr.21534 Akt. date 22.06.1999,

midis paleve te cilat rane dakord si me poshte :

**Neni 1 - Palet**

1.1 *Pala shitese:* Agjensia Kombetare e Privatizmit Tirane e perfaqesuar nga Drejtori i Pergjthshem i saj, Z. Qirjako Theodhori.

*1.2.Pala blerese:* "2K Group"Sh.p.k. i njohur si person juridik me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr.19653 Prot.,date 22.06.1998, perfaqesuar nga Z Koço Kokedhima i biri i Theodhoriut dhe i Efijeni i lindur ne Qeparo Vlore me 21.04.1959 me numer pasaporte 0183354 madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me adrese banimi : Rruga "5 Maji" Tirane, i shpallur fitues ne ankandit e zhvilluar date 25 Tetor1999 ne Agjencine Kombetare te Privatizimit, i njohur me autorizimin Nr.3076, date 25.10.1999." per kryerjen e pagese se vleftes se plote te paketes shteterore te aksioneve prej 51 % te "Industrialimpeks"Sh.a.. Tirane.

**Neni 2 - Objekti i kontrates**

Objekt i kesaj kontrate eshte shitja (transferimi) e 51% te aksioneve e barabarte me 21930 aksione te zoteruara nga Shteti Shqiptar, perfaqesuar nga Ministria e Ekonomise Publike e Privatizimit, ne "Industrialimpeks" SH.A.Tirane, me vlere 7.000.000 leke (shtate miljon).

Kapitali themeltar i shoqerise ne momentin e regjistrimit ne Gjykaten e Rrethit Tirane me vendimin Nr.21534 date 22.06.1999, te pasqyruar edhe ne Akt themelimin dhe Statutin e shoqerise rezulton me vlere 43.000.000 leke (dyzet e tre miljon) me 43.000 aksione me vlere nominale te nje aksioni 1000 leke, kapital sipas vleresimit ne dokumentin bilanci reformuar i bazuar mbi bilancin ushtrimor te vitit 1997 i specifikuar : a) shuma e ndertesave me vlere 15.582.166 leke dhe b) vlera e truallit siperfaqe 559.3 m2 sipas genplaneve dhe akt-vleresimeve qe shoqerojne keto genplane me vlere 422.582 leke.

**Neni 3 - Çmimi i shitjes.**

3.1.Çmimi i shitjes se paketes se aksioneve prej 51% te zoteruar nga shteti ne shoqerine "Industrialimpeks" SH.A. Tirane eshte 7.000.000 leke (shtatemiljon). vlere e realizuar ne ankandin e dates 25.10.1999 ne Agjencine Kombetare te Privatizimit dhe paguar plotesisht nga pala blerese ne Banken e Kursimeve, Dega Tirane. numri i llogarise 4302 (Dega e Thesarit) ne favor te Agjensise Kombetare te Privatizmit.

3.2.Pala shitese deklaron se ne favor te saj eshte derdhur e gjithe shuma e percaktuar ne piken 3.1 te ketij neni para perpilimit te kesaj kontrate sipas mandat arketimeve leshuar nga Banka e Kursimeve me numer 295127 date 11 Nentor 1999 per 6.998.000 leke (gjashte miljon e nenteqind e nentedhjete e tete mije) dhe nr.0918168 date 12 Nentor 1999 per 2000 leke (dymije) .Vlefta totale e paguar nga pala blerese eshte 7.000.000 leke (shtate miljon).

**Neni 4 - Kushtet e shitjes**

4.1.Pala blerese gjykohet se ka njohuri te plota per paketen e 51 % te aksioneve qe i eshte ofruar per blerje , me oferten e dhene nga ajo.

4.2.Pala blerese ka plotesuar te gjitha kushtet e percaktuara nga pala shitese ne autorizimin Nr.3076 prot, date 25.10.1999(njemije e neneteqind e netedhjete e nente) te Agjencise Kombetare te Privatizimit Tirane.

4.3.Pala blerese pas nenshkrimit te kesaj kontrate. noterimit te saj behet pergjegjese per te gjitha detyrimet ligjore ndaj shtetit qe mund te lindin ne lidhje me regjistrimin e kesaj pakete aksionesh prej 51 % qe nga momenti i firmosjes se kesaj kontrate.

4.4.Pas firmosjes se kesaj kontrate dhe noterimit te saj, pronesia e prej 51 % e aksioneve e barabarte me 21930 aksione te Sh.A. "Industrialimpeks" Tirane transferohet nga Ministria e Ekonomise Publike e Privatizimit tek "2K Group"Sh.p.k. perfaqesuar nga Z.Koço Kokedhima, ne perputhje me objektin e kesaj kontrate.

**Neni 5 - Te drejtat dhe detyrimet e bleresit**

5.1. Bleresi ka pranuar blerjen e paketes shteterore prej 51 % te aksioneve te Sh.A. "Industrialimpeks" Tirane sipas proces-verbalit te zhvillimit te ankandit dhe akt

marreveshjes se nenshkruar per kushtet e privatizimit te paketes se aksioneve date 25.10.1999 zhvilluar ne Agjencine Kombetare te Privatizimit.

5.2 Bleresi fiton te drejten e pronesise mbi paketen prej 51 % te aksioneve te blera prej tij pas firmosjes se kesaj kontrate ne perputhje me legjislacionin perkates.

5.3.Bleresi eshte pergjegjes per te mbuluar te gjitha shpenzimet ligjore dhe te noterise ne lidhje me rregjistrimin e kesaj shitjeje. Bleresi eshte pergjegjes per transferimin e titullit te pronesise ne emer te vet.

5.4.Pas nenshkrimit te kesaj kontrate, brenda 30-diteve, ne baze te ligjit Nr. 7843, date 13.07.1994 "Per regjistrimin e pasurive te paluajteshme", pala blerese eshte e detyruar te paraqitet ne Zyren e Regjistrimit te Pasurive te Paluajteshme te Rrethit Tirane.

**Neni 6 –Te drejtat dhe detyrimet e shitesit.**

6.1. Pala shitese garanton bleresin per pronesine e plote dhe te ligjshme te shtetit mbi paketen prej 51 % te aksioneve te SH.A. "Industrialimpeks " Tirane, te ofruara per blerje pales blerese.

6.2. Pala shitese garanton bleresin per perputhjen e kesaj kontrate me frymen e legjislacionit civil ne Republiken e Shqiperise si dhe te drejtat ligjore te bleresit ne lidhje me pronesine mbi kete objekt kontrate perballe organeve gjyqesore ne rast kontestimi te kontrates , kur kjo kerkohet

**Neni 7 -Baza ligjore per lidhjen e kontrates**

1. Kodi Civil i Republikes se Shqiperise;
2. Ligji Nr. 7512, date 10.08.1991;
3. Ligji Nr. 7638, date 19.11.1992;
4. Ligji Nr. 8334, date 23.04.1998
5. _.VKM.Nr.446, date 09.07.1998,
6. VKM Nr. 405, date 31.08.1999;
7. VKM Nr. 407, date 31.08.1999;
8. Udhezimi Nr. 3, date 01.10.1999;
9. Aktmarrveshja nenshkruar midis paleve diten e zhvillimit te ankandit date 25.10.1999.
10. Urdheri i Ministrit te Ekonomise Publike e Privatizimit Nr. 319, date 07.09.1999.

**Neni 8 - Dokumentat ligjore qe i bashkengjiten kesaj kontrate**

8.1.Urdheri i Ministrit te Ekonomise Publike e Privatizimit, Nr. 319, date 07.09.1999, per privatizimin e paketes prej 51% te SH.A"Industrialimpeks " Tirane me dy flete fotokopje e noteruar.

8.2.Autorizimi Nr.3076 Prot., date 25.10.1999, per kryerjen e pageses se vleres se plote te paketes se aksioneve prej 51 % te SH.A., "Industrialimpeks" Tirane leshuar nga Agjencia Kombetare e Privatizimit me dy flete fotokopje e noteruar.

8.3.Shkresa e Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit derguar Agjencise Kombetare te Privatizimit me Nr.7145 Prot., 08.11.1999 me kater flete fotokopje e noteruar.

8.4.Akt-marreveshje date 25.10.1999 nenshkruar midis paleve ne kete kontrate diten e zhvillimit te ankandit,me nje flete fotokopje e noteruar.

8.5.Shkresa e Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit Nr.7145/1 prot., date 11.11.1999 me nje flete fotokopje e noteruar.

**Neni 9 – <u>Te ndryshme</u>**

9.1.Kjo kontrate iu lexua gojarisht paleve. Kjo kontrate, me kerkesen e paleve perpilohet ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe me nga 4 faqe prej te cilave nje kopje qendron ne Zyren e Noteres, nje kopje ne arshiven e Agjensise Kombetare te Privatizimit dhe dy kopje i jepen pales blerese.

9.2.Pala shitese pasi e kuptoi permbajtjen e gjeti sipas vullnetit te tij te lire e te plote po keshtu pala blerese pasi e kuptoi permbajtjen e gjeti sipas vullnetit te tij te lire e te plote. Ne kete moment palet e nenshkruan kontraten ne pranine e noterit pa asnje pretendim. Une noterja , ne baze te Ligjit Nr. 7829, date 01.06.1994 "Per Noterine" si dhe legjislacionit perkates per shitjen e paketes se aksioneve te zoteruara nga shteti ne shoqerite anonime e vertetoj ate sipas ligjit.

***PALET KONTRAKTUESE***

***PALA SHITESE***

QIRJAKO THEODHORI

Qirjako Theodhori

DREJTOR I PERGJITHSHEM I AKP.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE
Nr 3007 Rep 21.12.99
VERTETIM
Z. ... me Nr Pasaporte
Paraqiti Dokumentin Origj Unë Vërtetoj
që Fotokopja Është një me Origjinalin
AFERDITA HAXHIA
TIRANE

***PALA BLERESE***

"2K GROUP"Sh.P.K.

PERFAQESUAR NGA

Z.KOÇO KOKEDHIMA

Koço Kokedhima

2K-GROUP Shpk TIRANE ALBANIA

22.12.1999

21534/1
7517

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SH.A."INDUSTRIALIMPEKS" Tirane**

REPUBLIKA E SHQIPERISE AFERDITA HAXHIA NOTERE TIRANE

**Date: 03.12.1999**

# KERKESE

**KERKUESI:** Drejtori i shoqerise "Industrialimpeks" Sh.A. regjistruar si person juridik prane Gjykates se Rrethit Tirane me vendim Nr. 21534 date 22.06.1999

**OBJEKTI :** Depozitimi i Vendimeve Nr.1, 2, 3 dhe Proces-verbalit te mbajtur nga mbledhja e Jashtezakonshme e Aksionereve te shoqerise "Industrialimpeks" sh.a. Tirane ne date 22.11.1999

**BAZA LIGJORE:** Dispozitat e ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar dhe formalitet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare"

**GJYKATES SE RRETHIT**
**TIRANE**

Të depozitohet kërkesa dhe aktet. më. 28.12.1999 Gjyqtare [illegible]

Z. Kryetar,
Shoqeria "Industrialimpeks" Sh.A eshte themeluar dhe regjistruar ne Regjistrin Tregetar te Gjykates Rrethit Tirane me Vendim Nr. ~~21534~~, date 22.06.1999.

Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" pas njoftimit ne gaZeten "Shekulli" per mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te aksionereve te Sh.A. "Industrialimpeks" Tirane e mbledhur ne daten 22.11.1999 ne seline e shoqerise dhe ne pranine e Noteres Aferdita Haxhia vendosi ndryshimin e Statutit te shoqerise, ndryshimin e perberjes se Keshillit Mbikqyres te shoqerise dhe ndryshimin e Ekspertit Kontabel te Autorizuar.

Ne baze te ligjit 7667 date 28.10.1993 "Per Rregjistrin Tregtar dhe formalitet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare" kerkojme nga ana e Gjykates se Rrethit Tirane depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te aktave te poshteshenuara:

- Vendim nr. 319 dt. 07.09.1999
- Shkresë e A.K.L.N.E.L dt. 08.11.1999 (7 fletë)
- Kontratë shitje Nr. 3440 Prot dt. 17.11.1999 (4 fletë)
- Gazeta: Emri i Aksionareve (2 fletë)
- Akt marrëveshje Nr. 3027 Rep dt. 24.12.1999 Noterizimi
- Shkresë A.K.P Autorizim për marrjen e pagesës Nr. 3009 Rep. dt. 21.12.1999
- Vendim Nr. 1 dt. 22.11.1999
- Vendim nr. 2 dt. 22.11.1999
- Vendim nr. 3 dt. 22.11.1999.
- Proces-Verbal dt. 22.11.1999 (6 fletë)
- Proces-verbal dt 25.11.1999 Nr 2847 Rep
- Statut Nr. 2847 Rep. 18.10.1999 (7 fletë)
- Autorizim Nr. 715411 dt. 24.11.1999

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE
AGJENCIA KOMBETARE E PRIVATIZIMIT
Nr. ____ Prot.

Tirane, ________ 1999

L E N D A : Autorizim per kryerjen e pageses se vleftes se plote te paketes shteterore te aksioneve prej 51 % te Sh.A. "Industrialimpeks"Tirane.

**SH.A. "Industrialimpeks "Tirane**

**TIRANE**

**MINISTRISE SE EKONOMISE PUBLIKE E PRIVATIZIMIT**

**MINISTRISE SE BASHKEPUNIMIT EKONOMIK DHE TREGTISE**

**TIRANE**

**"2K GROUP", perfaqesuar nga KOÇO KOKEDHIMA**

**Adresa: Rruga "5 Maji"**

**TIRANE**

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 8334, dt. 23.04.1998, VKM Nr. 446, dt. 09.07.1998, VKM Nr. 405, dt. 31.08.1999, urdherit te Ministrit te Ekonomise Publike e Privatizimit Nr. 328 date 07.09.1999, te proces-verbalit te mbajtur gjate zhvillimit te ankandit dhe te raportit perfundimtar te tij, Agjencia Kombetare e Privatizimit

AUTORIZON

Shitjen e paketes shteterore te aksioneve prej 51% te Sh.A. "Industrialimpeks" Tirane ne favor te "2K Group", perfaqesuar nga administratori i saj, z. Koço Kokedhima. Çmimi i vendosur nga ankandi eshte 7.000.000 leke (shtate milion). Zoti Koço Kokedhima ka bere paraprakisht pagesen prej 2.100.000 leke (dymilion e njeqind mije) me garanci bankare Nr.0320.25.10.1999, dhe numer serial 00913, leshuar nga Banka e Tiranes.

Vlefta e plote e paketes se aksioneve do te paguhet me para ne dore. Derdhja e shumes prej 4.900.000 leke (katermilion e nenteqind mije ) do te kryhet prane Bankes se

Kursimeve. Dega e Thesarit Tirane ne llogarine 4302. ku te cilesohet destinacioni i derdhjes.

Shitja e paketes se aksioneve prej 51% te kesaj shoqerie behet me keto kushte:

1. Pavaresisht nga çmimi i vendosur ne ankand, pjesemarrja ne kapitalin e shoqerise eshte 51%.

2. Pagesa e vleftes se plote te rezultuar nga ankandi te behet brenda dates 24 Nentor 1999.

Mosplotesimi i ketyre detyrimeve ne afatet e percaktuara ne kete autorizim ngarkon me pergjegjesi fituesin e ankandit "2K Group", perfaqesuar nga Z. Koço Kokedhima dhe behet shkak per pavlefshmeri te ketij autorizimi.

Ne rast se pagesa e plote nuk kryhet brenda afatit te percaktuar ne kete autorizim, atehere mbahet pagesa paraprake prej 30% e kryer nga "2K Group", perfaqesuar nga Z. Koço Kokedhima.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE
Nr 3009 Rep 21.12.1999
VERTETIM
Z ... me Nr Pasaporte
Paraqiti Dokumentin Origj Unë Vërtetoj
që Fotokopja Është një me Origjinalin /

**Qirjako Theodhori**

**Drejtor i Pergjithshem**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENSIA KOMBETARE E PRIVATIZIMIT
KESHILLI I MINISTRAVE
TIRANE

AFERDITA HAXHIA
TIRANE

PULLE TAKSE
50 LEKE
R. SHQIPERISE